L I G J
Nr.9563, datë 19.6.2006

PËR RATIFIKIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË KUSHTETUTËN E ORGANIZATËS BOTËRORE TË SHËNDETËSISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohen ndryshimet e neneve 24 e 25 të Kushtetutës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të miratuara nga Asambleja e Pesëdhjetenjëtë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4960, datë 5.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

ASAMBLEJA
E PESËDHJETË E NJË E ORGANIZATËS BOTËRORE TË SHËNDETIT
GJENEVË 11-16 MAJ 1998

WHA51.23 Amendamente të neneve 24 dhe 25 të Kushtetutës

Duke pasur në konsideratë se anëtarësia në Bordin Ekzekutiv duhet të rritet nga 32 në 34, në mënyrë që numri i anëtarëve në Rajonin Europian dhe në Rajonin e Paqësorit Perëndimor që kanë të drejtën të përcaktojnë një person për të shërbyer në Bordin Ekzekutiv të rritet respektivisht në tetë dhe pesë,

1. Miraton amendamentet e mëposhtme në nenet 24 dhe 25 të Kushtetutës, tekstet e të cilave në gjuhët angleze, arabe, kineze, spanjolle, frënge dhe ruse janë njëlloj të besueshme.

Neni 24

Abrogohet dhe zëvendësohet nga

Bordi do të përbëhet nga tridhjet e katër persona të përcaktuar nga po kaq anëtarë. Asambleja e Shëndetit, duke pasur në konsideratë një shpërndarje të drejtë gjeografike, do të zgjedhë anëtarët që kanë të drejtë të përcaktojnë një person për të shërbyer në Bord, me kusht që jo më pak se tre prej këtyre anëtarëve, do të zgjidhen prej organizatave rajonale të themeluara në përputhje me nenin 44. Secili prej këtyre anëtarëve do të caktojë në Bord një person teknikisht të kualifikuar në fushën e shëndetit, i cili mund të shoqërohet në këtë post nga persona të tjerë zëvendësues apo këshilltarë.

Neni 25

Abrogohet dhe zëvendësohet nga

Këta anëtarë do të zgjidhen me një mandat trevjeçar dhe mund të rizgjidhen, me kusht që, prej anëtarëve të zgjedhur në sesionin e parë të Asamblesë së Shëndetit të mbajtur pas hyrjes në fuqi të amendimit të Kushtetutës që rrit anëtarësinë e Bordit nga 32 në 34, mandati i qëndrimit në detyrë i anëtarëve shtesë të zgjedhur, të jetë më i vogël për aq sa është e nevojshme, në mënyrë që të mundësohet zgjedhja e të paktën një anëtari për çdo organizatave rajonale në një vit.

2. Vendos që dy kopje të kësaj rezolute do të vërtetohen me firmën e kryetarit të Asamblesë së Pesëdhjetë e një të Organizatës Botërore të Shëndetit dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Shëndetit, një kopje e të cilave do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, që është Depozitari i Kushtetutës dhe kopja tjetër do të depozitohet në arkivin e Organizatës Botërore të Shëndetit;

3. Vendos që njoftimi i pranimit të këtyre amendamenteve prej anëtarëve në përputhje me dispozitat e nenit 73 të Kushtetutës do të hyjë në fuqi pas depozitimit të një instrumenti formal pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, ashtu siç kërkohet për pranimin e Kushtetutës nga neni 79(b) i po kësaj Kushtetute.

(Mbledhja e dhjetë plenare, 16 maj 1998-Komiteti B, raporti i katërt).